

**BASHKIA KOLONJË**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

- Autoriteti: Bashkia Kolonjë  
Adresa Sheshi “ Rilindja ”  
Tel/Fax +355 812 23173 ; 08122225 ; 2232  
E-mail bashkia.kolonje@gmail.com  
Faqja e Internetit <http://www.kolonja.gov.al>
- Dhënie me qira të fondit pyjor dhe kullosor në përdorim, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Njësia Administrative	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Nr. Parcelës Pyjore	Objekti i veprimtarisë.	Sipërfaqja		Vlera dysheme e qirasë Lekë/vit/ha	Kohë zgjatja (Vite)
						Ha	Km		
1	Fshati Qafëzes Rruga “Qafëze-Psari Zi”, Bashkia Kolonjë	3083	852 (852/1)	96	Për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.	3 ha		143,000	10
TOTALI									

3. Qëllimi i dhënies me qira të fondit pyjor dhe kullësor, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
4. Konkurrimi do të zhvillohet më datë: 31.10.2024, ora 11:00, në Sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
5. Çmimi dysheme i qirasë, është  
Lloji inproduktive në vlerën: 143,000 (Njëqind e dyzet e tremijë) lekë/ha në vit.
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.
7. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
  - a) Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
  - b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
  - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, ( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
  - d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
  - e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
  - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
  - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
  - h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
  - i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
  - j) Afati i qirasë.
  - k) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.
  - l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
  - m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
  - n) Vërtetim që ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara).
  - o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
8. Oferta të paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e

personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.

9. Sigurimi i ofertës

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës, Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit. Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.

10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, ( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen ..... 15 pikë.
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.
- e) Masën e qerasë për ha/vit .....35 pikë.

11. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 (shtatë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkuruesit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

12. Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 31.10.2024, para orës 11:00.